

Sesion informues mbi parandalimin e pastrimit të parave, në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, zhvilloi sesionin informues me studentë të programit të studimit të drejtësisë, ekonomisë dhe gazetarisë, mbi parandalimin e pastrimit të parave

Kjo nisëm ka si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi fenomenin e pastrimit të parave, pasojat ekonomike, sociale zhvillimore që sjell dhe mënyrat e parandalimit të tij.

